

VENDIM
Nr. 1/3, datë 15.1.2021

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, e ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pika “a” dhe “c”; dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, ‘Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

a) Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje personale nr. 360, në ngarkim të A. M., me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1963–1973. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

2. Dosje formulare nr. 1099, në ngarkim të Xh. K., me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1977–1979. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

3. Dosje formulare nr. 1363, në ngarkim të Xh. K., me 106 (njëqind e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1967–1979. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

4. Kartelë model 2 nr. 519, në ngarkim të N. B., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është “Tepër sekret”. Kartela daton në vitin 1967. Kartela i përket Fondit ish-Dega IV.

5. Kartelë model 2, në ngarkim të F. N., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është “Tepër sekret”. Kartela daton në vitin 1952. Kartela i përket Fondit ish-Dega IV.

6. Dosje e problemit të centralizuar “Gorilla” nr. 978, me 6 vëllime, me 1776 (njëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet në dosje datojnë deri në vitet 1981–1986. Dosja i përket Fondit ish-Dega IV.

7. Fashikulli “Renegati” nr. 295, me 398 (treqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1974–1987. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

8. Lista e veçimit nr. 1, datë 16.12.1990, dhe vendimi për heqjen nga kontrolli operativ 2/B dhe asgjësimi i dosjes formulare nr. 8585, në ngarkim të H. C., me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1989–1990. Dokumentet i përkasin Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

9. Dosje fashikullore nr. 21, me procese të të arratisurve shqiptarë dhe të dërguar nga shteti armik, me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1962–1966. Dosja i përket Fondit ish-Dega e Punëve të Brendshme Pogradec.

10. Kartelë model 2 nr. 516,692, në ngarkim të Sh. S., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është “Tepër sekret”. Kartela daton në vitin 1958. Kartela i përket Fondit ish-Dega IV.

11. Dosje formulare nr. 105, në ngarkim të Sh. S., me 123 (njëqind e njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1962–1987. Dosja i përket Fondit ish-Operativ.

12. Dosje formulare nr. 7937, në ngarkim të Ll. K., me 81 (tetëdhjetë e një) fletë dhe 6 (gjashtë) fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1963–1989. Dosja i përket Fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

13. Dosja nr. 347, “Për disa komente e propagandën armiqësore që bëhen në ushtri lidhur me situatën aktuale dhe ngjarjet në Evropën Lindore”, me 107 (njëqind e shtatë) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4, Drejtoria e I.

14. Dosja nr. 558, “Mbi hyrjet e paligjshme në ambasada në Tiranë”, me 4 (katër) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4, Drejtoria e I.

I. Deklasifikimin pjesërisht të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që gjendet në:

1. Fondin Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, fletë regjistri, i Regjistrit të Agjenturës, nr. 2, konkretisht rreshti me nr. rendor 1396, në ngarkim të F. F., me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “Tepër sekret”.

KRYETAR
Gentiana Sula